

**Thirrje publike për personat e interesuar për aplikim për krijimin e regjistrit /bazës të ekspertëve të jashtëm të cilët mund të ndihmojnë në procesin e sqarimit të skringut dhe procesin e negociatave për aderimin e Republikës së Maqedonisë drejt Bashkimit Evropian.**

Zyra e Kryetarit të Qeverisë të Republikës së Maqedonisë dhe Sekretariatit për Çështje Evropiane bën thirrje publike për aplikim të të gjithë të interesuarve për krijimin e regjistrit/bazës të ekspertëve të jashtëm, të cilët mund të ndihmojnë në procesin e sqarimit të skringut dhe procesin e negociatave për aderim të Republikës së Maqedonisë drejt Bashkimit Evropian.

Qëllimi i kësaj thirrjeje është krijimi i regjistrit/bazës të ekspertëve të jashtëm, në të cilët Qeveria e Republikës së Maqedonisë mund të mbështetet gjatë rrjedhës së procesit të sqarimit të skringut dhe procesit të negociatave për aderim të Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian dhe të cilët do të mund ti angazhojë kohë pas kohe, në afat të shkurtër, apo në afat të gjatë kohor.

Të gjithë të interesuarit mund të aplikojnë për një ose më shumë kapituj nga e drejta e BE-së, respektivisht fushat, temat dhe nën-temat në kuadër të kapitujve nga e drejta e BE-së.

Dokumentacioni i nevojshëm për paraqitje të të gjithë personave të interesuar përbëhet nga:

- CV (Curriculum Vitae) dhe

- Letër Motivim duke theksuar saktë kapitujt, respektivisht fushën, temat dhe nën-temat brenda kapitujve të së drejtës së BE-së, për të cilën personi i interesuar ka ekspertizë.

Të gjitha dokumentet të dorëzohen në gjuhën maqedonase dhe angleze, respektivisht gjuhë shqipe dhe angleze.

**Aplikimet detyrimisht dorëzohen në mënyrë elektronike në mail adresën në vijim: [eupregovori@vlada.gov.mk](mailto:eupregovori@vlada.gov.mk) me Lëndë : Thirrje për ekspertë të BE-së, më së voni deri në 10 tetor 2018, deri në ora 20:00.**

## Procesi i negociatave për aderimin e Republikës së Maqedonisë drejt Bashkimit Evropian

Negociatat për aderim drejt Bashkimit Evropian (BE) zhvillohen drejt rrugës së konferencës mes-Qeveritare, mes shteteve anëtare të BE-së dhe shtetit- kandidat. Negociatat zhvillohen mbi kushtet nën të cilat një shtet do të aderojë drejt BE-së dhe fokusohen në pranimin dhe implementimin e korpusit të legjislacionit të BE-së (acquis). Acquis është e ndarë në kapituj të numërt (33) dhe secili prej tyre mbulon sfera specifike të politikës dhe për të cilët negociohet veçmas. Negociatat ndihmojnë shtetin –kandidat të përgatitet për përmbushjen e detyrimeve të cilat dalin nga anëtarësimi në BE. Ata gjithashtu i ndihmojnë BE-së të përgatitet për zgjerimin lidhur me kapacitetin e integritit (më herët i referuar si kapacitet për absorbim). Pasi që të mbyllen negociatat për të gjithë kapitujt, rezultatet nga negociatat do të inkorporohen në draft Marrëveshjen për aderim drejt BE-së (Accession Treaty)

Lëndë e negociatave janë vetëm kushtet dhe korniza kohore për pranim, implementim dhe zbatim të legjislacionit të përgjithshëm të BE-së (acquis) nga ana e shtetit- kandidat. Gjithashtu, gjatë negociatave aderuese diskutohet edhe për marrëveshje financiare (si p.sh. se sa shteti i ri anëtar do të kontribuojë, respektivisht shfrytëzojë mjete nga buxheti i BE-së, në formën e transfereve), si dhe për angazhimet e përkohshme (në disa raste, rregullat e caktuara aplikohen gradualisht, me qëllim që t'i jepet kohë shtetit-të ri anëtar apo atij ekzistues që të përshtatet).

Negociatat për çdo kapitull bazohen në këto elemente:

1. Skringu për legjislacionin nacional dhe shkalla e përputhshmërisë së tij me të drejtën evropiane – Komisioni Evropian zbaton hulumtim detajor së bashku me shtetin –kandidat për secilën fushë të politikës (kapitull), me qëllim që të përcaktojë se sa mirë është i përgatitur shteti. Gjetjet sipas kapitujve prezantohen nga ana e Komisionit Evropian para shteteve- anëtare të BE-së, në formë të Raportit për skring. Konkluzioni i këtij Raporti është rekomandim nga KE-ja ose në mënyrë të drejtpërdrejtë të hapen negociatat, ose të kërkohet përmbushja e kushteve të caktuara – kritereve, që duhet të përmbushen para se të hapen negociatat për kapitujt përkatës.
2. Pozitat negociuese - para nisjes së negociatave, shteti- kandidat duhet të dorëzojë pozicionet e veta dhe BE duhet të miratoj pozicione të përbashkëta. Për më shumë kapituj, BE do të përcaktojë kritere për mbylljen e negociatave të cilat duhet të jenë të përmbushura nga ana e shtetit- kandidat, që të mund të mbyllet kapitulli. Veçanërisht për kapitujt 23 dhe 24 KE-ja propozon që, në të ardhmen këta kapituj të hapen në bazë të planeve aksionare me kritere afatmesme të cilat duhet të përmbushen, para se të caktohen kriteret për përmbylljen e kapitujve.